

VENDIM

Nr. 738, datë 9.9.2015

PËR SHPËRBLIMET E ANËTARËVE TË BORDIT TË AKREDITIMIT DHE GRUPEVE TEKNIKE TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 13, e 11, pika 3, të ligjit nr. 116/2014, "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e shpërblimit për anëtarët e grupeve teknike të punës për çdo pjesëmarrje është 3 000 (tre mijë) lekë dhe kryhet në fund të vitit financiar.
2. Masa e shpërblimit për anëtarët e Bordit të Akreditimit për çdo pjesëmarrje është 5 000 (pesë mijë) lekë dhe kryhet në fund të vitit financiar.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama